



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 179/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Xhevdet Abazi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes për Vetëvendosje (LVV) dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega Prizren, për shkak të vendosjes së banerit mbi rrugë publike, për Zgjedhjet e parakoshme parlamentare në Republikën e Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 08.06.2014, mori këtë:

### VENDIM

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega Prizren i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 1750 ( njëmijë e shtatëqind e pesëdhjetë ) euro të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

### Arsyetim

Me datën 05.06.2014, LVV, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se, me datë 04.06.2014, diku rreth orës 14:00 aktivistja Marigone Drevinja e LVV – je ka vërejtur se në rrugën “Adem Jashari” – në Prizren, ishte vendosur baneri mbi rrugë publike i kandidatit për Kuvendin e Kosovës Enver Hoxhaj nga subjekti politik PDK-së. Sipas parashtruesit të ankesës në kuptim të dispozitës së nenit 4.1 pika (b) të Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013 vendosja e banerit mbi rrugë publike përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e provës e ka mabshakgjitur një fotografi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik- Partin Demokratike të Kosovës, me datën 05.06.2014, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 06.06.2014 deri në ora 17:00.

PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë sipas afatit të caktuar, në të cilën përgjigje është theksuar se subjekti politik PDK, ka ndërmarr të gjitha masat e parapara për evitimin e shkeljes së pretenduar, duke e argumentuar më fotografi të ofruar si dëshmi për largimin e banerit në fjalë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjindet në shkresat e lëndës shihet qartë se baneri i kandidatit për Kuvendin e Kosovës Enver Hoxhaj nga radhët e subjektit politik PDK, ishte vendosur baneri mbi rrugë publike në rrugën “Adem Jashari” – në

Prizren, veprim ky i cili është në kundërshtim me dispozitën e nenit 33 pika (b) të LZP-së të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, që ndalon vendosjen e banerëve mbi rrugë publike.

Gjatë përcaktimit të shumës së përshtatshme për gjobitjen e ndonjë subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë
- Masat, nëse ka pasur fare të tilla, të cilat janë ndërmarrë apo miratuar nga subjekti politik për të parandaluar shkelje të ligjeve përkatëse zgjedhore në Kosovë;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në ndonjë palë zgjedhje në të kaluarën.

PZAP-i, mori parasysh si rrethanat rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese, si rrethanë rënduese mori se subjekti politik në fjalë ka marrë pjesë në të gjitha zgjedhjet e mbajtura deri më tani në Kosovë dhe se supozohet se janë të njoftuar plotësisht me procesin zgjedhor dhe se i njëjti subjekt politik ka përsëritur shkelejn e të njëjtës natyrë si në këto zgjedhje poashtu edhe në zgjedhjet e kaluara.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese mori parasysh faktin që subjekti politik PDK, pas marrjes së Kërkesës për Përgjigje në ankesë dhe pas dhënies së urdhërit nga PZAP-i, për ta evituar shkelejn e pretenduar në ankesë, subjekti në fjalë i ka ndërmarrë të gjitha masat për përmirësimin e shklejes së supozuar, e cila çështje ka ndikuar në uljen e lartësisë së gjobës të shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi ngase sipas Rregullorës Nr. 01/2012 të PZAP-it për "Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave", gjoba lidhur me shkeljen e pretenduar në ankesë është 5100 euro.

PZAP-i, duke u bazuar në shkresat e lëndës konstatoi se subjekti politik PDK, ka rënë në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 pika b) të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, i cili parasheh se "Është e ndaluar vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve ose vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në apo mbi rrugët publike gjatë fushatës zgjedhore" dhe poashtu duke marrë parasysh të gjitha arsyet e lartcekura dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 179 /2014 më datën 08.06.2014.



#### ***Këshillë Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.